

**VENDIM**  
**Nr. 617, datë 24.7.2013**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.997, DATË 10.12.2010 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME**  
**SHËRBIM JASHTË QENDRËS SË PUNËS, BRENDË VENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr. 119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika I e vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“I. Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit. Përfshihen, për punonjësit operacionalë të Policisë së Shtetit, punonjësit e Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, dërgimi me shërbim jashtë qendrës së punës nuk kufizohet me ditët zyrtare të punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**